



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 117 Datë 22.08.2012

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “E.T.H.H” SH.P.K
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE
NGA HEC-ET “KOZEL”, “HELMES 1” DHE “HELMES 2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, neni 5 pika 1 gërma “a” dhe nenet 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.08.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E.T.H.H” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “E.T.H.H” sh.p.k, plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me Lejet nga institucionet e tjera (Pika e Lidhjes nga Rrjeti i Shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5), mungon. Por duke qënë se aksesit në rrjet të gjeneruesve të vegjël është i garantuar sipas Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, pika 29 e nenit 3 dhe neni 42, konsiderojmë se një kërkesë e kësaj lloji mund të plotësohet në një kohë tjetër pa cenuar procesin e liçensimit të kësaj subjekti.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë "E.T.H.H." sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et: "Kozel" me fuqi 0,5 MW, "Helmës 1" me fuqi 0,8 MW dhe "Helmës 2" me fuqi 0,5 MW për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria E.T.H.H sh.p.k të paraqesë në ERE Lejen e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes brenda 30 ditëve nga miratimi i saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI